



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ
CILËSIMI I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (9)

PLATFORMA POLITIKE E UÇK-së



*Shtëpia e veprimtarit Fatmir Maliq
Brajshori në Kodrën e Trimave në
Prishtinë, në të cilën u mbajt Mbledhja
e Katërt e Përgjithshme e LPK-së dhe
u vendos të kalohej në fazën e
organizimit të luftës së armatosur*



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-
përfaqësues politik i Ushtrisë
Çlirimtare të Kosovës, në
intervistën ekskluzive dhënë
"Epokës së re", në vazhdimin e
pjesës së nëntë, ka bërë me dije se
Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK)
është struktura politike që

themeloi Ushtrinë Çlirimtare të
Kosovës. Sipas tij, LPK-ja e
konsideronte luftën e armatosur si
të pashmangshme, prandaj filloi
angazhimin serioz në këtë drejtim.
"Duke përcaktuar si qëllim të
vetëm politik çlirimin e vendit nga
okupatorët, Lëvizja Popullore e

Kosovës ofroi platformën që
mundësonte të lireshin anash
dallimet klasore, ideologjike, fetare
dhe krahinore dhe të
mobilizoheshin të gjitha forcat
politike, shoqërore, intelektuale
dhe profesionale rreth këtij
qëllimi", thotë Bardhyl Mahmuti

**KMDLNJ-JA:
DËNOJMË FUQISHËM
SHKELJET QË
GJYKATA SPECIALE
RACISTE PO UA BËNË
PENGJEVE TË HAGËS**

FAQE 3



**XHAVIT HOXHA NË
2006-N: PUSHKA
ATDHETARE I MBYLLË
TË GJITHA SHTIGJET
E LIGËSISË, AJO
PAJTON EDHE GJAQË**

(Intervista botohet me rastin
e 16-vjetorit të vdekjes)

FAQE 6-7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**STOLTENBERGU NË SARAJEVË:
JEMI TË SHOQETËSUAR NGA RETORIKA
E NDARJES DHE NDIKIMI RUS** F. 2

**NIS GJYKIMI I PARË NË MUNGESË
PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË** F. 6

**IKSHPK-JA: UJI I BADOCIT SËRISH
ËSHTË I PIJSHËM** F. 3

EKONOMI



**FILLON PROCESI I REGJISTRIMIT TË
NDËRMARRJEVE SOCIALE** F. 7

**RRITJA E PAGAVE NË SEKTORIN
PUBLIK, DHOMA E TREGTISË: PO
RRITET DIFERENCA ME SEKTORIN
PRIVAT NGA 25 % NË 60 %** F. 7

SPORT



**KOSOVA PËRBALLET ME
BJELLORUSINË, GLIHA E ALITI:
TË VAZHDOJMË SERINË POZITIVE** F. 10

Stoltenbergu në Sarajevë: Jemi të shqetësuar nga retorika e ndarjes dhe ndikimi rus

SARAJEVË, 20 NËNTOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha të hënën në Sarajevë, se aleanca veriatlantike ndihet e shqetësuar nga retorika e ndarjes dhe ndikimi rus në rajon. Kjo ishte vizita e parë e shefit të NATO-s në Bosnjë-Hercegovinë. "Ajo kërcënon minimin e stabilitetit dhe dobësimin e reformave. Të gjithë liderët duhet të punojnë për të ecur përpara. Për ne është tejet me rëndësi dhe ne jemi të përkushtuar për sigurinë dhe stabilitetin e këtij rajoni, dhe vendit tuaj i cili ka shumë rëndësi për rajonin e Ballkanit Perëndimor, prandaj ne po e thellojmë dialogun politik dhe bashkëpunimin tonë praktik", tha Stoltenbergu në Sarajevë. Ai shtoi se aleatët "e mbështetin fuqishëm sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës". Stoltenbergu bisedoi edhe me kryetaren e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Borjana Krishto, mëngjesin e së hënës. Krishto tha se Bosnjë-

Hercegovina është pjesë e Planit të Veprimit të Anëtarësimit (MAP), i cili, sipas saj, tregon se ka vendim politik nga NATO-ja se ajo mund të bëhet anëtare e aleancës. "Ne duhet ta arrijmë një konsensus politik dhe përmes dialogut të vijnë deri te pozicionet të cilat janë shumë të rëndësishme për Bosnjë-Hercegovinë kur bëhet fjalë për bashkëpunimin me NATO-n", tha Krishto. Përfaqësuesi i lartë i Bosnjë-Hercegovinës, Christian Schmidt, tha pas takimit me Stoltenbergun, se është i nevojshëm ndërtimi i besimit në sundimin e ligjit në Bosnjë e Hercegovinë dhe se kjo është, në mesin e shumë gjërave, përgjegjësi e politikanëve vendorë. "Po punojmë rreth kësaj dhe kemi nevojë për mbështetjen e BE-së dhe NATO-s", tha Schmidt. Stoltenbergu e theksoi rëndësinë e përfaqësuesit të lartë për proceset e pajtimit në Bosnjë-Hercegovinë, duke shtuar se "çfarëdo tentimi për ta minuar pozicionin e tij do ta kthejë mbrapa Bosnjë-Hercegovinë".



Stoltenbergu mbërriti në Bosnjë të dielën vonë dhe darkoi me anëtarët e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës. Denis Bećiroviq, anëtar i Presidencës së Bosnjës, njoftoi në "Facebook" se gjatë vizitës, shefi i NATO-s tha se aleanca ushtarake mbetet garantues i sigurisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Bosnjë-

Hercegovinës. "Ai tha se NATO-ja nuk e aprovon një retorikë e cila nxit ndarje dhe e rrezikon funksionimin e institucioneve të shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Ai, po ashtu, nënvizoi se rrugët e Bosnjë-Hercegovinës drejt Evropës dhe NATO-s janë të qëndrueshme dhe se NATO-ja do t'i mbështetë proceset e

reformave të cilat e sjellin Bosnjë-Hercegovinë më pranë NATO-s dhe Bashkimit Evropian", shkroi Bećiroviq. Më parë, Stoltenbergu kishte deklaruar se Bosnjë-Hercegovina, bashkë me Gjeorgjinë dhe Moldavinë, iu përkasin vendeve që e meritojnë një vëmendje të veçantë nga NATO-ja.

Kuvendi shqiptar miraton në parim Projektligjin për Buxhetin mes tensionesh të larta

TI Ranë, 20 NËNTOR - Kuvendi i Shqipërisë e ka miratuar në lexim të parë Projektligjin për buxhetin e vitit 2024 të hënën, në një seancë që zgjati vetëm pesë minuta për shkak të tensioneve të larta, pasi deputetët e opozitës u përpoqën ta pengonin votimin. Deputetët e Partisë Demokratike (PD) ndezën flakadanë, palosën karrige përreth foltores dhe u konfrontuan me pjesëtarët e gardës. Duke e parë situatën e krijuar, kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, i kaloi menjëherë në votim Projektligjin për buxhetin e shtetit dhe paketën fiskale.



Projektligji u miratua pa asnjë diskutim duke marrë 73 vota për brenda një kohe tejet të shkurtër prej vetëm pesë minutave.

Tani Projektligji për buxhetin do të diskutohet nen për nen në komisionet parlamentare, të cilat janë përballur me pengesa

të ngjashme nga opozita. Ai pritet të dalë në votim në lexim të dytë në dhjetor. Kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste (PS), Blendi Çuçi, tha për gazetarët pas seancës se "PS-ja nuk mund ta lërë Shqipërinë pa buxhet pasi vendi nuk është në krizë, por Partia Demokratike". Por, Gazmend Bardhi, deputet opozitar, tha se grupi i deputetëve opozitarë të drejtuar prej tij nuk do të heqë dorë nga skenari i kaosit, duke e cilësuar si të vetmen "armë" që kanë në dorë. Buxheti 2024 prej 7 miliardë eurosh cilësohet nga qeveria si më i madhi deri tani për

shpenzime të planifikuara publike. Rritja ekonomike për vitin 2024 parashikohet të jetë 3.8 %. Buxheti mbështet rritje të pagave, duke bërë të mundur që brenda vitit 2024 të realizohet objektivi për të arritur një nivel mesatar page prej 900 eurosh në muaj. Vitin e ardhshëm pritet të investohen në projekte publike rreth 1.2 miliard euro, përfshirë 70 milionë euro për procesin e rindërtimit. Për pensionistët në vitin 2024 është parashikuar indeksimi i pensionit si dhe bonusi i fundvitit, me vlerë totale 77 milionë euro.

Nëntë të vdekur nga stuhia në Turqi

ANKARA, 20 NËNTOR - Ekipet e shpëtimit në Turqi kërkuan të hënën për 11 anëtarët e zhdukur të ekuipazhit të një anijeje mallrash që u fundos në Detin e Zi gjatë një stuhie e cila vrau së paku nëntë persona, përfshirë një nga anija, tha ministri i Brendshëm i Turqisë, Ali Yerlikaya. Ai tha se anija turke Kafkametler, me 12 anëtarë në bord, u fundos pranë bregdetit të Ereglit në veriperëndim të

provincës Zonguldak në Turqi dhe se trupi i pajetë i një anëtarit të ekuipazhit është nxjerrë. Kapiteni i anijes kishte raportuar të dielën në mëngjes se anija po shkonte drejt një valëthyesi në Eregli. Anija ka mundësi ta ketë goditur strukturën e valëthyesit. Turqia u godit nga stuhi të fuqishme të dielën, ndërsa moti i stuhishëm me shi ua

pamundësoi ekipeve të shpëtimit të kryenin operacione kërkimi përmes detit dhe ajrit deri të hënën në mëngjes. Yerlikaya tha se stuhitë dhe vërshimet nëpër Turqi gjatë fundjavës shkaktojnë vdekjen e katër personave në provincën juglindore, Batman, si dhe të tre personave të tjerë në Zonguldak dhe të një tjetri në Diyarbakir, po ashtu në juglindje.



Haxhiu thotë se nuk i ka emrat e kryerësve të veprës në rastin Dehari

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka dëshmuar të hënën para Prokurorisë Speciale në lidhje me rastin e vdekjes së aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Ajo pas dhënies së kësaj dëshmie ka mbajtur një konferencë për medie, duke thënë se po ta kishte emrin e kryerësve të veprës penale, s’do ta priste ftesën e prokurorit. Haxhiu ka theksuar se prokurori është ai që duhet të bëjë hetime. “Po ta kisha emrin e kryesit apo kryerësve të veprës penale unë nuk do ta prisja ftesën e prokurorit për ta thënë emrin e personit që dyshohet, e kjo është puna e tij, për këtë paguhet nga taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, për këtë ai është prokuror, që të bëjë hetime. Punën e tij unë nuk mund ta bëj”, ka thënë ajo. Haxhiu ka thënë se për rastin Dehari duhen hetime të mirëfillta, duke thënë se prokurori Afrim Shefkiu po e trajton me arrogancë këtë rast. “Nuk është bërë asgjë për zbardhje të vërtetës. Prokurori Shefkiu, përveç që nuk e ka

trajtuar, e ka trajtuar me arrogancë. Nuk iu përgjigj avokatit të familjes për hetimet e mëtutjeshme. Prokurori Shefkiu asnjëherë nuk e ka marrë mundin që t’u përgjigjet thirrjeve të avokatit të familjes për ta informuar më shumë familjen e Astritit lidhur me punën dhe hetimet që po bëhen. Me arrogancë reagoi edhe ndaj deklaratës sime së cilës i qëndroj dhe e ripërsëris sa herë të jetë nevoja. Le të më ftojë sërish për të dëshmuar. Do t’i përgjigjem njësoj sa herë të jetë nevoja”, ka thënë ministria Haxhiu, duke shtuar se hetimet e mirëfillta janë domosdoshmëri. “Prokurori i rastit duhet t’i kryejë hetimet në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të përpiktë, dhe nëse kjo kërkesë për të është e pamundur të realizohet, atëherë të mos bëhet personi që e pengon drejtësinë”, ka thënë ministria Haxhiu. Avokati i familjes së Astrit Dehari, Tomë Gashi, ka thënë se Prokuroria s’po e lejon atë ta kryejë punën e avokatit, pasi s’u lejua të hënën të jetë i pranishëm gjatë intervistimit të ministres Albulena Haxhiu. “Prokuroria për arsye të panjohura vepron në mënyrë selektive. Herë duke lejuar e herë duke mos lejuar pjesëmarrjen



time në intervistimin e dëshmitarëve në këtë rast. Arsyet mund t’i dijë vetëm prokurori i rastit, ndërsa ne mund vetëm të spekuojmë se për çfarë arsye prokurori po e lë të painformuar

familjen Dehari në rastin e vrasjes së djalit të tyre!”, ka thënë Tomë Gashi. Më 5 nëntor të vitit 2016 aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, ishte gjetur pa shenja jete

në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Që nga ajo kohë hetimi i vdekjes së tij kishte marrë kahe të ndryshme përderisa ishin kërkuar ekspertiza të shumta vendore dhe ndërkombëtare.

KMDLNj: Dënojmë fuqishëm shkeljet që Gjykata Speciale Raciste po ua bënë pengjeve të Hagës



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar pasi Gjykata Speciale gjatë fundjavës së kaluar ka ndërprerë telefonatat dhe komunikimet përmes videolidhjes (platformës zoom) mes të paraburgosurve dhe familjarëve të tyre. “Sipas informatave të KMDLNj-së, ndaj pengjeve që po mbahen në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës, si të paraburgosur, duke u gjykuar dhe në vuajtje të dënimit, kohëve të fundit u ishin nënshtruar disa kufizimeve në fushën e informimit e që përfundoi me ndërprerjen e paparalajmëruar të vizitave familjare dhe personave të tjerë që kishin marrë pëlqimin nga autoritetet e Gjykatës Raciste Speciale për vizita. Edhe komunikimi tjetër ishte ndërprerë, pa dhënë ndonjë sqarim. Vizitat ishin ndërprerë

krejtësisht në kohën e pandemisë mirëpo jo edhe komunikimet me familjarë dhe të tjerë përmes telefonit dhe formave tjera elektronike”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se shkeljet që u bëhen në vazhdimësi pengjeve nga Kosova në Hagë, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë, duhet të trajtohen seriozisht nga Komiteti Ndërkombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Degradues për faktin se askujt nga Kosova nuk i lejohet t’i vizitojë brenda hapësirës së burgut për ta parë trajtimin e tyre dhe kushtet fizike. “KMDLNj fuqishëm dënon shkeljet që Gjykata Speciale Raciste po ua bënë pengjeve të Hagës, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë sikur edhe heshtjen e institucioneve të Kosovës që, me dashje apo pa dashje, janë vënë në krahë të kësaj gjykate”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

IKShPK-ja: Uji i Badocit sërish është i pijshëm

Prishtinë, 20 nëntor- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se vlerat e manganit në ujin e liqenit të Badocit janë brenda standardeve për

konsum të qytetarëve. Përmes një njoftimi për medie, IKShPK-ja ka njoftuar se së bashku me Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” kanë ndërmarrë

masat e nevojshme që gjendja e ujit të ishte brenda standardeve dhe që vlerat e manganit të ishin të lejuar për pije. “Vlerat e manganit në ujin e liqenit dhe në rrjetin shpërndarës në ditët e

fundit rezultojnë brenda standardeve të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 10/2021 ‘Cilësia e Ujit për konsum nga njeriu’”, ka njoftuar IKShPK-ja.





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (9)

Platforma politike e UÇK-së

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së nëntë, ka bërë me dije se Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) është struktura politike që themeloi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Sipas tij, LPK-ja e konsideronte luftën e armatosur si të pashmangshme, prandaj filloi angazhimin serioz në këtë drejtim. “Duke përcaktuar si qëllim të vetëm politik çlirimin e vendit nga okupatorët, Lëvizja Popullore e Kosovës ofroi platformën që mundësonte të liheshin anash dallimet klasore, ideologjike, fetare dhe krahinore dhe të mobilizoheshin të gjitha forcat politike, shoqërore, intelektuale dhe profesionale rreth këtij qëllimi”, thotë Bardhyl Mahmuti

PRISHTINË, 20 NËNTOR-
“Epoka e re”: Në fillim të aktivitetit të Grupit Diplomatik të UÇK-së shpesh përmendej se gjatë takimeve është shpalosur platforma politike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Meqenëse deri më sot asnjëherë nuk është publikuar ndonjë dokument lidhur me këtë platformë, çfarë mund t’i thuhet lexuesit rreth kësaj çështjeje?
Bardhyl Mahmuti: Që në fillim duhet të qartësojmë për ata që nuk e dinë, se Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) është struktura politike që themeloi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kjo organizatë patriotike kishte për qëllim bashkimin e të gjitha

forcave politike dhe shoqërore shqiptare që angazhoheshin për realizimin e të drejtave tona kombëtare, pa marrë parasysh dallimet klasore, ideologjike, fetare apo krahinore. Çlirimi i vendit nga okupatorët shekullorë përbënte boshtin kurrizor rreth të cilit artikulohej tërësia e veprimtarisë politike të LPK-së. Në funksion të këtij orientimi politik kjo organizatë i përcaktoi vetes për qëllim të mbronte politikisht, financiarisht dhe ushtarakisht domosdoshmërinë e luftës së armatosur për realizimin e aspiratave kombëtare.
“Epoka e re”: Përpara se të fillonte

shpërbërja e Federatës së Jugosllavisë, LPK-ja në atë kohë quhej Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës dhe angazhohej për krijimin e republikës së Kosovës, në kuadër të së cilës do të përfshiheshin të gjitha territoret me shumicë shqiptare që ishin nën Jugosllavi. Sipas disa deklaratave të anëtarëve të dikurshëm të kryesisë së LPK-së, më 17 nëntor 1994, kryesia e kësaj organizate kishte prurë vendim që të emëroheshin njësitë e armatosura të udhëhequra nga LPK-ja me emrin Ushtria Çlirimtare e Kosovës. A mund të thuhet se nga kjo datë kemi edhe përcaktimin e qëllimeve të lartpërmendura për ta mbështetur UÇK-në në të gjitha

format e mundshme?
Bardhyl Mahmuti: Shpërthimi i luftërave të armatosura gjatë procesit të shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë krijoi kontekstin e ri historik që imponoi rishikimin e kërkesave politike dhe mjeteve që duhej të përdroreshin për realizimin e tyre. Përdorimi shumica e forcave politike shqiptare që vepronin në viset shqiptare që dikur ishin nën Jugosllavi predikonin zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare nëpërmjet mjeteve demokratike-paqësore, LPK-ja konsideronte luftën e armatosur si të pashmangshme. Prandaj filloi angazhimin serioz në këtë drejtim. Ka njerëz që datën e emërimit të njësisë të armatosura që vepronin nën udhëheqjen e LPK-së e paraqesin si datë të themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe lëshohen në spekulime se kush ishte kumbara që “pagëzoi” UÇK-në. Lindja e UÇK-së i ka rrënjët në gjakun dhe sakrificat e shumta të atdhetarëve që u mobilizuan për realizimin e aspiratave kombëtare të shqiptarëve që mbetën nën Jugosllavi dhe është rezultat i një procesi e jo i një vendimi.
“Epoka e re”: Meqenëse rreth kësaj çështjeje nuk ka konsensus të përgjithshëm as në mesin e

veprimtarëve të LPK-së, ju në cilën kohë do ta do ta përcaktonit lindjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?
Bardhyl Mahmuti: Pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981, organizatat atdhetare shqiptare që vepronin në atë kohë (Organizata-+ Marksiste-Leniniste, Fronti i Kuq Popullor, Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe Kushtrimi i Lirisë), që ishin, në një farë forme, vazhdimësi e organizatave të krijuara pas ripushtimit të trojeve tona në vitin 1945 nga regjimi komunist jugosllav, ranë në ujdë që të bashkoheshin rreth kërkesës për krijimin e republikës së Kosovës. Në këtë kontekst po përmend faktin se Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, që udhëhiqej nga Jusuf Gërvalla, kishte moto: **“Me penë dhe pushkë për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë socialiste!”** Për dallim nga periudhat e përparshme të rezistencës kur si pasojë e arrestimeve dhe vrasjeve rezistenca merrte kohë për t’u riorganizuar, **Pranvera e Madhe ’81** vuri në binarë lokomotivën që, pa u ndalur fare, do të shpinte në

realizimin e aspiratave tona kombëtare. Gjaku i Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, dhe gjaku i të gjithë të rënëve në përballje me okupatorët, traso i rugën e vetme drejt lirisë sonë! Rënia e heronjve të lartpërmendur dhe aksionet e armatosura të bashkëveprimtarëve të tyre shënojnë momente të rëndësishme të luftës sonë të armatosur dhe pasqyrojnë pjesën më madhështore në procesin e formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj, sipas pikëpamjeve të mia, formimi i UÇK-së duhet të shihet si proces, ku çdo sakrificë ka vendin e vet, ndërsa në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme të LPK-së të mbajtur në Prishtinë më 26-27 korrik 1993 (në këtë mbledhje u vendos edhe ndërrimi i emrit nga LPRK në LPK), paraqet një moment kyç në këtë proces, sepse pikërisht në këtë mbledhje u vendos të fillohej me strukturimin e celulave të armatosura që kishin kryer aksione kundër okupatorit në forcë ushtarake që do ta merrte përsipër çlirimin e vendit.

“Epoka e re”: Nga ajo që thatë më lart del se platforma e Lëvizjes Popullore të Kosovës për çlirimin e vendit ishte platformë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. **Bardhyl Mahmuti:** Plotësisht e saktë. Duke përcaktuar si qëllim të vetëm politik çlirimin e vendit nga okupatorët, Lëvizja Popullore e Kosovës ofroi platformën që mundësonte të lireshin anash dallimet klasore, ideologjike, fetare dhe krahinore dhe të mobilizoheshin të gjitha forcat politike, shoqërore, intelektuale dhe profesionale rreth këtij qëllimi.

“Epoka e re”: Përkundër angazhimeve të Lëvizjes Popullore të Kosovës që përballë okupatorëve të lihen anash dallimet ideologjike ndërmjet forcave politike shqiptare, gjatë gjithë periudhës që i parapriu luftës çlirimtare ju keni pasur epitetin e një force politike të majtë (marksiste-leniniste). A është i qëndrueshëm pohimi se ju ishit politikisht të majtë dhe deri në çfarë mase kjo çështje ka qenë pengesë për koordinimin e veprimtarisë me forcat e tjera politike për çlirimin e vendit? **Bardhyl Mahmuti:** Që të kuptohet drejt kjo çështje e shoh të rëndësishme të sqaroj disa aspekte teorike që lidhen me nocionet në fjalë. Fillimisht po tërheq vëmendjen e lexuesit se dallimi thelbësor ndërmjet doktrinës marksiste-leniniste dhe nacionalizmit si ideologji lidhet me çështjen kombëtare. Përdërisa komunistët e të gjitha rrymave kombin e shohin të ndarë në klasa dhe i japin përparësi luftës së klasës punëtore kundër klasës së borgjezisë dhe predikojnë rreshtimin përkrah proletariatit ndërkombëtar, nacionalizmi përpiket t’i fshijë të gjitha dallimet klasore, ideologjike, fetare, krahinore etj., brenda kombit me qëllim që të dilet unik kundër kombeve të tjera që përpiqen ta rrezikojnë interesin e tij. Të gjitha aktet normative të LPK-së (Programi, Statuti dhe shkrimet në “Zërin e Kosovës”) kanë qenë pikërisht në frymë të tejkalimit të dallimeve klasore, ideologjike, fetare dhe krahinore të shqiptarëve dhe për unitetin kombëtar për t’u bërë ballë sfidave me të cilat ballafaqohej kombi ynë. Në kuadër të lëvizjes sonë ka pasur njerëz ateistë dhe fetarë, të majtë dhe të djathtë, nga Kosova, nga viset që mbetën nën Maqedoni, nën Mal të Zi, nga Lugina e Preshevës dhe nga

Shqipëria, intelektualë të profileve të ndryshme, punëtorë, bujq, të papunë etj., por që i bashkonte veprimtaria për çlirimin e vendit. **“Epoka e re”:** Si e shpjegoni faktin se, siç del edhe nga motoja që përmendët më lart, qëllimi i LPK-së ka qenë “bashkimi me vendin amë, Shqipërinë socialiste”. **Bardhyl Mahmuti:** Shqiptarët që mbetën në kuadër të tri republikave të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë diskriminoheshin nga komunistët serbë, maqedonas, malazezë mbi bazën e përkatësisë së tyre kombëtare. Prandaj kërkesa për republikë në kuadër të kësaj federate socialiste ishte krijimi i republikës për ta hequr diskriminimin kombëtar që ushtrohej ndaj nesh dhe nuk kishte të bënte me funksionimin ideologjik të shtetit socialist jugosllav. Është plotësisht e natyrshme se në një kontekst historik, ku në mesin e shumë shteteve të tjera të Evropës Qendrore, Juglindore dhe Lindore edhe Jugosllavia dhe Shqipëria ishin vende ku partitë komuniste kishin pushtetin, bashkimi me Shqipërinë socialiste shihej si e vetmja mundësi për heqjen e plotë të diskriminimit kombëtar. Synimi politik i LPK-së për t’u bashkuar me vendin amë ka qenë i njëjtë pavarësisht se kush ka qenë në pushtet në Shqipëri. Çështja e pushteteve në Shqipëri nuk e ka përcaktuar orientimin ideologjik të LPK-së: synimi për t’u bashkuar me shtetin amë në kohën kur Shqipëria udhëhiqej nga komunistët nuk e bën LPK-në organizatë të orientimit të majtë, siç nuk e bën as të orientimit të djathtë duke ruajtur të njëjtin synim edhe gjatë kohës kur, pas përmbykses së regjimit komunist, në pushtet erdhi e djathta. Në kohën kur shqiptarët shtypeshin “djathtas”, “majtas” dhe “në

qendër”, ndasitë ideologjike “e djathtë”, “e majtë” dhe “e qendrës” çonin ujë në mullirin e armikut! **“Epoka e re”:** A ka pasur në mesin e veprimtarëve të LPK-së të tillë që kanë glorifikuar figurën e Enver Hoxhës? **Bardhyl Mahmuti:** Ka kaluar gati gjysmë shekulli nga periudha për të cilën flasim dhe ndodh të ketë të tillë që nuk e dinë se Shqipëria ishte e vetmja shpresë ku ëndërronim ta gjenim përkrahjen për çlirim nga thundrat jugosllave. Të gjithë adhuresit e Enver Hoxhës e kanë dashur për shkak të kësaj shprese dhe kanë mundur të jenë shumë të paktë ata që ta kanë lavdëruar për angazhimet komuniste. **“Epoka e re”:** Enver Hoxha ka zhvilluar një luftë të ashpër klasore në Shqipëri. Si mund të pajtohet orientimi i LPK-së për të lënë në heshtje dallimet klasore dhe fetare brenda kombit shqiptar me qëndrimin zyrtar të Shqipërisë socialiste? **Bardhyl Mahmuti:** Atë që theksoni ju është plotësisht e saktë. Në rrafshin e brendshëm, fatkeqësisht, Partia e Punës ka zhvilluar një luftë të ashpër klasore dhe kundër religjioneve në funksion të qëllimit për të arritur një shoqëri pa klasa dhe pa fe që ka lënë pasoja shumë të mëdha për kohezionin kombëtar. Ndërsa në raport me shqiptarët që jetonin jashtë Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, strategjia ka qenë e kundërt: kultivimi i atdhedashurisë dhe bashkimi rreth aspiratave kombëtare si në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. **“Epoka e re”:** Ku e mbështetni pohimin e tillë? **Bardhyl Mahmuti:** Po përmend vetëm krenntimin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Krenntimi i periudhës së krijimit të shteteve kombëtare në këtë pjesë të Evropës Juglindore ka një rëndësi të madhe për arsye se aktualizojë aspiratën për bashkimin në një shtet të vetëm kombëtar shqiptar të territoreve shqiptare që gjatë sundimit të Perandorisë Otomane ishin të shpërndara në katër njësi administrative (vilajete). Me qindra shkrime që trajtonin rëndësinë historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, udhëheqësit e së cilës kishin shtruar për herë të parë programin politik për themelimin e shtetit shqiptar në tërësinë territoriale ku banonin shqiptarët. Me qindra poezi, pjesë teatrale, këngë, romane, piktura, skulptura dhe vepra të fushave të ndryshme iu kushtuan kësaj periudhe historike. Emërues i përbashkët i të gjitha veprave në fjalë ishte unifikimi kombëtar duke lënë anash ndasitë e ndryshme që na karakterizojnë si komb. **“Epoka e re”:** Me cilin shembull konkret mund ta ilustroni këtë që thoni? **Bardhyl Mahmuti:** Edhe në një rast tjetër e kam theksuar se gjeneratës që ishte në ballë të *Pranverës së Madhe ’81* i kujtohet se nga të gjitha veprat shkencore dhe të krijimtarisë artistike të asaj dekade, kënga “Xhamadani i trimërisë” u shndërrua në emblema, që këndohej si të ishte himn kombëtar. Po rikujtoj se fjalia kryesore e kësaj kënge theksonte se “Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola”! (...) Mjafton të thuhet se nuk mund të gjendet shembull më i bukur i ideologjisë kombëtare se ky rast, ku fshihen të gjitha dallimet klasore, ideologjike, rajonale, fetare, gjinore dhe futen në një kategori: të gjithë shqiptarët janë një!”

(Muhamet Mavraj / Vizion)



Shtëpia e veprimtarit Fatmir Maliq Brajshori në Kodrën e Trimave në Prishtinë, në të cilën u mbajt Mbledhja e Katërt e Përgjithshme e LPK-së dhe u vendos të kalohej në fazën e organizimit të luftës së armatosur.

Gjenden eshtra në Prekaz të viktimave nga lista e personave të zhdukur

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Pas gërmimeve në lokacionin Arbanë të Prizrenit, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur ka njoftuar se janë duke vazhduar gërmimet në

Prekaz të Skenderajt. Sipas njoftimit për medie, ekipet e gërmimit edhe të hënën kanë hasur në eshtra, mbetje mortore, që potencialisht iu përkasin viktimave të listës së personave të zhdukur.

“Gërmimet po vazhdojnë ende dhe në do t’ju njoftojmë pas rezultateve të ADN-së për identifikimet e mundshme të këtyre trupave”, ka njoftuar Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur.



Nis gjykimi i parë në mungesë për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka nisur gjykimi i parë në mungesë për krime lufte ndaj të akuzuarit Çedomir Aksiq. Ai akuzohet për krime lufte të kryera gjatë periudhës janar-maj të vitit 1999 në Kosovë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të cilën e drejtoi kryetarja e trupit gjykues, Violeta Namani-Hajra, si mbrojtës i Aksiqit është paraqitur Zharko Gajiq.

Prokurorja Habibe Salihu tha se i kanë shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore me qëllim që të sigurohet prania e të akuzuarit, por kjo nuk është arritur. “U vërtetua dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari Çedomir Aksiq, në periudhën kohore janar-maj 1999, duke bashkëvepruar me një grup njerëzish kriminalë, tani për tani të paidentifikuar, të organizuar, të veshur me uniforma policore, paramilitare, ushtarake, ka shkaktuar vuajtje të mëdha apo cenim të integritetit trupor ose të shëndetit, frikësim ndaj popullatës së pambrojtur civile, vrasje, urdhërim për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqet që lidhen me konfliktet e luftës, drejtuar me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt apo luftë”, tha Salihu derisa lexoi aktakuzën ndaj Çedomir Aksiqit. Sipas aktakuzës, adresa e Aksiqit, i cili nuk ishte i pranishëm në gjykim, është në Naupare-Krushevac në Serbi, ndërsa vendi i lindjes është në Shtime. “Në këto momente nuk do të shtoj asgjë derisa t’i shqyrtoj të gjitha provat në afat prej 30-ditësh”, tha mbrojtja e Çedomir Aksiqit, avokati Zharko Gajiq, pasi dëgjoi aktakuzën e lexuar nga prokurorja. Në fund të seancës, gjyqtarja e



rastit, Violeta Namani-Hajra, e udhëzoi mbrojtësin e të akuzuarit që ta paraqesë kërkesën për ta hedhur poshtë aktakuzën apo për t’i kundërshtuar provat në një afat prej 30-ditësh.

Çfarë thotë aktakuza?

Sipas aktakuzës, Çedomir Aksiq, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, kishte urdhëruar dëbimin e banorëve të lagjes në pikën e quajtur “Kodra e Gështenjave”, vend midis fshatrave Mulapolc, Reçak dhe Petrovë në komunën e Shtimes. Aktakuza thotë se ata më pas kishin djegur shtëpitë e të dëmtuarave duke u shkaktuar kështu dëme morale dhe materiale. Sipas aktakuzës, në vendin e quajtur “Lugu i Neshës”, në Petrovë të Shtimes, Çedomir Aksiq e kishte ekzekutuar një person, familjen e të cilit paraprakisht e kishte ndaluar.

Gjithashtu, sipas aktakuzës, Aksiq kishte marrë pjesë në vrasjen e Hajriz Brahimit, Hakin Muratit, Sabri Muratit, Arif Muratit, Ahmet Mustafes, Sadik Mujotës, Skënder Halitit dhe Hanumshahe Mujotës në Reçak. Sipas aktakuzës, Aksiq është i lindur në Shtime, por adresa e tij aktuale është në Serbi. Aktakuza ndaj Çedomir Aksiqit, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ishte ngritur më 4 maj të këtij viti. Ky është rasti i parë i gjykimit në mungesë, me të cilin përballet gjykata në Prishtinë dhe lejohet me Kodin e ri të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Çfarë thotë Kodi i Procedurës Penale?

Mbajtja e gjykimeve në mungesë parashihet kur i akuzuari heq dorë vetë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimet gjyqësore.

Gjykimi mund të mbahet në mungesë të të akuzuarit dhe kjo mund të bëhet kur prokuroria dhe gjykata t’i kenë shtjerrë të gjitha mjetet për sigurimin e pranisë së të akuzuarit.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, neni 303, gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues mban seancë dëgjimore për të përcaktuar përse i akuzuari mungon dhe për të vlerësuar çdo sqarim apo dëshmi nëse i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim. Aty thuhet, po ashtu, se për marrjen e këtij vendimi gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues merr parasysh nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta gjetur të akuzuarin.

Çfarë prodhojnë gjykimet në mungesë?

Më herët nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Prishtinë (FDH) ishin

shprehur kundër aktakuzave dhe gjykimeve në mungesë. “Edhe pse në fillim mund të duket që viktimat janë të kënaqura me drejtësinë, më vonë shumica e tyre zhgënjehen, sepse edhe në rastet kur dikush dënohet, kur e kuptojnë viktimat që ndoshta kryesi i krimit nuk do të prangoset, është një zhgënjim për viktimën”, ishte shprehur Bekim Blakaj nga FDH-ja.

Blakaj kishte shprehur edhe shqetësim për kohën që mund të marrë nisja dhe përfundimi i këtyre gjykimeve. “Rreziku është se kanë kaluar më shumë se 24 vjet nga kryerja e krimeve të luftës. Në shumicën e rasteve, Prokuroria është mbështetur në dëshminë e dëshmitarëve, nuk është që ka pasur prova materiale ose mjekoligjore. Rreziku është që dëshmitarët të vdesin ose ta humbin memorien”, kishte thënë ai.

Por, Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi kishte thënë për “Radion Evropa e Lirë” se gjykimet në mungesë janë të rëndësishme për familjarët e viktimave, “që të zbardhen krimet dhe e vërteta”. “Ata mund ta shfrytëzojnë pastaj të drejtën e kompensimit nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të Krimit, sipas ligjit dhe procedurës së paraparë”, thotë ai.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës deri tani ka ngritur gjashtë aktakuza për krime lufte me propozimin që gjykimi të zhvillohet në mungesë dhe duke arsyetuar që janë shterur të gjitha përpjekjet ligjore për t’i gjetur të pandehurit.

Në luftën e viteve 1998-1999 mbi 13 000 civilë besohet se janë vrarë në Kosovë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur. Të pagjetur, edhe sot e kësaj dite, mbeten mbi 1 600 persona, shumica prej tyre shqiptarë.

Tahiri kritikon qeverinë: Nuk ka strategji, shkon në dialog pa u ndëshkuar Serbia

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për qasjen në dialog. Tahiri në “Facebook” ka shkruar se qeveria nuk ka asnjë

strategji sa i përket dialogut. Për sulmin në Banjskë ajo thotë se qeveria vetëm po raporton. “Qeveria jonë nuk udhëheq por vetëm raporton (për sulmin në Banjskë). Asnjë strategji nuk ka, madje BE-

ja bëri një veprim hoqi ndërmjetësuesit dhe vuri tre liderë evropianë. Serbia nuk u ndëshkua, ndërsa këtë javë qeveria merr pjesë në dialog pa u ndëshkuar Serbia”, ka shkruar Tahiri.



Fillon procesi i regjistrimit të ndërmarrjeve sociale

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - “Vizionin për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë e kemi shprehur kaherë, ndërsa punën dhe vullnetin për ta bërë atë vizion realitet, e kemi dëshmuar përmes hartimit dhe zbatimit të politikave për një ekonomi sa më gjithëpërfshirëse”, kështu e nisi fjalën e tij kryeministri Albin Kurti në takimin me përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe bizneseve për informim rreth regjistrimit si ndërmarrje sociale. Ai në emër të Qeverisë së Kosovës paraqiti edhe një arritje tjetër në këtë drejtim, e që për herë të parë në Kosovë qeveria ofron mundësinë që organizatat joqeveritare dhe bizneset të regjistrohen dhe ta marrin statusin e ndërmarrjeve sociale.

Pra, në vendin tonë, tha më tej ai, kemi ndërmarrje publike, kemi ndërmarrje private, por kemi edhe ndërmarrje sociale. “Lehtësirat të cilat do t’ua ofrojmë ndërmarrjeve sociale në njërin anë e inkurajojnë aktivizimin në tregun e punës të personave nga grupet e cenueshme, ndërkaq në anën tjetër sigurojnë rishpërndarjen e të hyrave për t’u shërbyer pikërisht këtyre grupeve. Edhe të rritet punësimi, por njëkohësisht edhe mirëqenia. Punësimi në fillim, përmes inkuadrimin, ndërkaq mirëqenia në fund, përmes rishpërndarjes së fitimeve”, ka deklaruar kryeministri.

Teksa iu drejtua bizneseve dhe organizatave joqeveritare, Kurti tha se të dyja në veprimtarinë e tyre tashmë kanë punë me personat nga grupet e cenueshme, e kësaj kryeministri veçoi se po ua paraqesin procesin e regjistrimit të ndërmarrjeve sociale dhe po i informojnë rreth



përfitimeve, që lehtësojnë punën e tyre në shërbim të këtyre grupeve të shoqërisë.

Ndërkaq, ministri i Financave, Hekuran Murati, ka theksuar se si qeveri në mënyrë të vazhdueshme kanë zbatuar politikat të cilat i adresojnë pabarazitë si në tregun e punës, po ashtu edhe në nivelin e të hyrave në familje.

Murati ka thënë se sot po paraqesin fillimin e procesit të ndërmarrjeve sociale, ndërmarrje këto që karakterizohen nga iniciativa e lirë, përkrahja për grupet e cenueshme si dhe vullnetarizimi.

Ndërmarrjet sociale përdorin fondet e tyre për ta avancuar

misionin shoqëror e në përkrahje të këtij misioni ato pranojnë edhe lehtësira përgjatë operimit të tyre, për t’u kualifikuar për regjistrim si ndërmarrje sociale, si biznese ose OJQ që ofrojnë shërbime të ndryshme për grupe të cenueshme, përfshirë këtu edhe shërbime shëndetësore, rezidenciale, psiko-sociale dhe të aftësisimit profesional.

Organizatat joqeveritare dhe bizneset që ofrojnë shërbime të ndryshme për grupet e cenueshme, përfshirë këtu shërbime shëndetësore, rezidenciale, psiko-sociale dhe të aftësisimit profesional, mund të

aplikojnë për ta marrë statusin e ndërmarrjeve sociale. Gjithashtu, përveç ofrimit të shërbimeve, edhe kompanitë/OJQ-të që punësojnë së paku 30 për qind të punonjësve nga grupet e cenueshme dhe bëjnë prodhimin apo përpunimin e produkteve, mund të aplikojnë për ta marrë statusin e ndërmarrjeve sociale. Para se të aplikojnë, bizneset/OJQ-të duhet ta definojnë qartë fushëveprimtarinë, klasifikimin në kategorinë A apo B si dhe mënyrën e shpërndarjes së fitimit duke pasur parasysh se deri në 30 për qind e fitimit mund të shpërndahet për paga dhe mëditje, ndërsa pjesa tjetër shkon

për zgjerim apo investim në veprimtarinë e tyre.

Për të aplikuar për të fituar statusin e ndërmarrjes sociale, OJQ-të/bizneset dërgojnë dokumentet e nevojshme për aplikim te Divizioni për Ndërmarrjet Sociale në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Pas aplikimit, Komisioni për Vlerësimin e Statusit të Ndërmarrjes Sociale i pajis bizneset/organizatat të cilat kualifikohen me certifikatë të ndërmarrjes sociale ku MFPT për ta lehtësuar rrugën e tyre drejt arritjes së misionit të tyre shoqëror ofron disa përfitime.

Rritja e pagave në sektorin publik, Dhoma e Tregtisë: Po rritet diferenca me sektorin privat nga 25 % në 60 %

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës përmes një reagimi publik ka shprehur shqetësimin për thellimin e diskriminimit të sektorit privat krahasuar me atë publik, pasi parashihet të bëhet ngritja e pagave në sektorin publik e që, sipas saj, po rritet dallimi me sektorin privat nga 25 % në 60 %.

Në njoftimin e bërë thuhet se me vendimin e fundit të marrë në mbledhjen e qeverisë për paga, koeficienti nga njëqind e pesë (105) euro siç ishte për vitin 2023 pritet të kalojë në njëqind e dhjetë (110) euro në vitin 2024 për të punësuarit në sektorin publik që në numër janë rreth 83 mijë persona. “Një praktikë e tillë është premtuar se do të vazhdojë të ndiqet edhe gjatë viteve në



vazhdim. Sektori privat i cili është gjeneratori kryesor i ekonomisë së vendit e ku të punësuar janë mbi 300 mijë punëmarrës vazhdon të mbetet në një gjendje të rëndë. Për

informim për vitin 2021 paga mesatare në sektorin privat ka qenë 490 euro, përderisa në sektorin publik për vitin 2021 ka qenë 612 euro, në vitin 2022 ishte

620, ndërkaq në vitin 2023 është 730 euro, ndërsa për vitin 2024 pritet të jetë 780 euro, pra dallimi mes këtyre dy sektorëve po shkon vetëm duke u thelluar”, thuhet në reagim.

Më tutje në reagim thuhet se nga 25 %, dallimi po rritet në 60 %.

“Nga popullsia në moshë pune, 61.4 % nuk janë ekonomikisht aktivë, ndërsa të punësuar, sipas të dhënave të publikuara në Anketën e Fuqisë Punëtore për vitin 2022 nga Agjencia e Statistikave, janë vetëm 403 813 persona apo 33.8 %, shumica prej tyre janë të punësuar pikërisht në sektorin privat. Andaj, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës kërkon nga kryeministri dhe Qeveria e Kosovës, trajtimin me prioritet edhe të sektorit privat ashtu sikur që po trajtohet sektori

publik, në mënyrë që të mos diskriminohen bizneset dhe njëkohësisht as të punësuarit e këtij sektori. DHTIK, po ashtu, kërkon të merren parasysh kërkesat e vazhdueshme të cilat i kemi përcjell te qeveria dhe ministrinë e që deri më tani, fatkeqësisht, kanë hasur në vesh të shurdhër, kërkesa këto konkrete, në mesin e të cilave përfshihet ndryshimi i Ligjit të Punës, përkatësisht Pushimit të Lehonisë, Ligjit për Procedurat Tatimore, krijimi i ofertës konkrete për investitorët, krijimi i arkës ‘Patriot’, ndryshimi i Ligjit për Tregti të Brendshme, kërkesa e DHTIK që TVSh-ja të paguhet në inkasim dhe jo vetëm”, është theksuar në reagimin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës.

Khavit Hoxha: Pushka atdhetare i mbyllë të gjitha shtigjet e ligësisë, ajo pajton edhe gjaqe

(Intervista me Khavit Hoxhën është botuar në gazetën “Epoka e re” më 5 qershor 2006. Ribotohet sot me rastin e 16-vjetorit të vdekjes së tij. Intervistën e kishte realizuar Kadri Rexha)



Khavit Hoxha është një nga veprimtarët e orëve të para të Lëvizjes Çlirimtare të Kosovës. Anëtar i organizatës LNÇKVShJ, ish-i burgosur politik, pishtar i arsimit në atdhe dhe në diasporë, pinjoll i derës Hoxha, e quajtur ndryshe Oda e Junikut, e njohur për atdhetarizëm, për pleqëri të drejtë dhe për tradita luftarake, vëlla i dëshmorit të kombit, gjeneralmajorit Edmond Hoxha. Kundërrevolucionarë, armiq të bashkim-vëllazërimit, nacionalistë, separatistë, irredentistë, shqiptaromëdhenj... Këto ishin vetëm disa nga epitetet me të cilat pushteti komunist jugosllav, përfshirë këtu edhe atë të Kosovës, zhvillonte luftën e vet propagandistike kundër pjesëmarrësve në demonstratat e mars-prillit të vitit 1981 në Kosovë dhe kundër kërkesave të tyre të ligjshme për liri dhe të drejta kombëtare. Një qasje të veçantë ndaj disa prej këtyre epiteve, qasje që pavarësisht torturave të egra të përjetuara, në të shumtën e rasteve është dëshmuar me guxim dhe vendosmëri edhe para gjykatave dhe në burgje brenda e jashtë Kosovës nga ish-të burgosur politikë, qoftë grupisht, qoftë individualisht, gjatë bisedës sonë, me rastin e 25-vjetorit të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, na e sjell Khavit Hoxha. “Kur na kanë quajtur nacionalistë dhe irredentistë nuk kanë hyrë në hak me ne sepse të tillë edhe kemi qenë. Njëherë e përgjithmonë kemi

dashur të çlirohemi dhe të bashkohemi me shtetin amë, me Shqipërinë e ëndrrave dhe të realitetit tonë. Fatkeqësisht, nuk kishim armë më të madhe se mendimin, letrën dhe grushtet tona të thata”, thotë me këtë rast Hoxha.

“Epoka e re”: Zoti Hoxha, na flisni diçka ju lutem për fillimet e veprimtarisë suaj politike?

Khavit Hoxha: T’i përgjigjesh kësaj pyetjeje është njësoj si t’i përgjigjesh pyetjes: pse kam lindur? Fillimisht oda e burrave. Bisedat për gjërat më të thjeshta. Legjendat dhe historitë e ndryshme. Këngët dhe rrëfimet për trimat. Analizat politike të burrave më të urtë. Dëgjimi me derë të mbyllur i Radio Tiranës dhe Radio Kukësit. Fjalët e mësuesit në klasën e parë. Lojërat në shkollë. Përqafimi i butë i nënës. Ofshamat e thella të babës... Është zor të zihet filli i gjithë kësaj... Konkretisht këtë punë mund ta lidhi me miqësinë time të hershme me Jashar Salihun dhe shokë të tjerë, qysh si nxënës. Bisedat tona të pashtershme dhe preokupimi ynë rinor për të kaluarën, për krimet e mëdha që kishin bërë serbët në trevën tonë, për librat e ndaluara, për Adem Demaçin, për Naim Frashërin, Gjergj Fishtën... Këngët që i këndonim për trimat dhe sidomos kënga për Oso Kukën. Në bisedat tona dashur pa dashur hynte edhe emri Shqipëri, Kosovë, Lidhje e Prizrenit, Luftëra Ballkanike, Traktati i Londrës, ndarje, bashkim... Pos me

shokët e mi të rinisë, rrethi me njerëz të ngjashëm më këtë ide po rritej me kohën. Vazhdimisht gjëja shokë të brezit tim që mirëfilli kuptoheshim se çiftelitë tona rrihnin të njëjtin tel. Në këto rrethana, disa, preokupim yni zuri të bëhej organizimi i mirëfilltë ilegal për çështje të çlirimit të Kosovës dhe të bashkimit të saj me Shqipërinë. Busull orientuese në këtë drejtim e kishim Adem Demaçin dhe Lëvizjen e tij legjendare. Në derën e preokupimit tonë më vonë trokiti edhe i madhi Jusuf Gërvalla.

“Epoka e re”: Pra, kyçja juaj në aktivitetin patriotik nuk është e rastit?

Khavit Hoxha: Në aktivitetin tim patriotik nuk ka pasur rastësi. Në këtë drejtim çdo gjë e kam bërë me paramendim dhe me bindje të plotë. Së pari i kam peshuar gjërat mirë e mirë me vetveten: e kam ditur se veprimtaria atdhetare kërkon përkushtim, bindje të fortë, vendosmëri, ideal të lartë kombëtar, përcaktim të qartë politik dhe gatishmëri deri në flijim për sfidat që paraqiten. Dhe, isha i bindur se të gjitha këto virtyte i kam. Pra, përcaktimi im për këtë veprimtari ishte i hershëm dhe qëndrimin dhe qëllimin e kisha të qartë.

“Epoka e re”: Si u bëtë anëtar i LNÇKVShJ-së, përkatësisht Komitetit të Deçanit? A e gjetët ju Lëvizjen apo Lëvizja ju gjeti ju?

Khavit Hoxha: Unë mendoj se vetë puna e shpie individin tek

organizata. Pra, puna e përditshme, sjellja dhe sidomos bisedat qofshin ato të rastit apo të qëllimshme e zbulojnë individin dhe përcaktimin e tij sipas shembullit: gjuha shkon atje ku dhemb dhëmbi. Kështu organizatës i mbetet të interesohet për të dhe me barometrat që ka të bëjë matjen e karakterit dhe të disa veçorive të individit dhe në bazë të testimit bëhet edhe shkalla e afrimit të tij deri te anëtarësimi. Kështu disa ka ngjarë edhe me mua. Unë, për shembull, kishte kohë që punën propagandistike e kisha bërë edhe pa qenë anëtar i organizatës ilegale, bile pasi u bëra anëtar më duhej të isha shumë më i matur ngase më nuk i përkisja vetvetes. Më nuk mund të thosha le të bëhet çka të bëhet, e paguaj vetë me lekura time, por duhej të kisha parasysh Organizatën, qëllimin e saj, ruajtjen e shokëve dhe kështu me radhë. Dhe, pikërisht në këtë çështje mendoj se ka qëndruar edhe dobësia e Organizatës sonë.

“Epoka e re”: Më konkretisht, ju lutem?

Khavit Hoxha: Shumica e anëtarëve të Komitetit të Deçanit për orientimin politik të tyre njiheshin si nga populli ashtu edhe nga UDB-a. Disa nga ta ishin edhe të përcjellur nga spiunët, si bie fjala Ismajl Haradinaj, Hasan Ukëhaxhaj, Muhamet Rogova etj. Unë dhe Muhamet Rogova shoqëroheshim shumë, bile

dilnim dhe vizitonim shumë fshatra të Dukagjinit. Bisedat tona me nxënës dhe me njerëz të ndryshëm si në rrugë, si në shëtitore, si në odat e burrave dhe gjetiu kishin për temë çështje historike, probleme kombëtare, kulturore, traditën tonë, gjendjen ekonomike dhe sociale të popullit, duke mos lënë anash politikën e përgjithshme botërore. Pos theksimit të robërisë së Kosovës dhe çështjes së pazgjidhur kombëtare në përgjithësi, ne propagandonim edhe për luftën, përgatitjen e gjithanshme për të, sepse lufta jonë për liri ishte në prag. Prandaj, ky propagandim yni i hapur, me shpatë mbi setër, ka pasur edhe tagrin e vet të lartë.

Shkruanim parulla, shpërndanim pamflete, gazeta ilegale dhe libra të ndaluara

“Epoka e re”: A s’na thoni me pak fjalë historikun e Komitetit të Deçanit? Formimin, platformën, anëtarësinë dhe shtrirjen gjeografike të veprimtarisë?

Khavit Hoxha: Në bazë të programit dhe të statutit Komiteti i Deçanit ishte vazhdimësi e LNÇKVShJ-së, me zanafillë në vitin 1963, e themeluar nga Adem Demaçi me platformë politike “çlirimin e krahinave shqiptare dhe bashkimin e tyre me nënën e vetë-Shqipërinë”. Themelimi i Komitetit daton menjëherë pas zbulimit dhe rënies në burg të aktivistëve të organizatës

LNÇKVShJ në vitin 1979. Udhëheqës i Komitetit në Kosovë ishte Ismajl Haradinaj, ndërsa jashtë atdheut ishte Jusuf Gërvalla, i cili në vitin 1979 kishte arritur t'i ikë arrestimit nga UDB-a dhe ishte vendosë në Ludëigsburg të Gjermanisë. Lidhjet e Jusufit me Komitetin e Deçanit mbaheshin nëpërmjet veprimtarëve tanë të besueshëm. Pas demonstratave të mars-prillit 1981 edhe Organizata jonë e përkrahu kërkesën taktike gjithëpopullore “Kosova Republikë”, por nga strategjia jonë për bashkimin kombëtar nuk kemi hequr dorë asnjëherë. Veprimtaria e tërësishme e Komitetit është e shumanshme dhe për të shpalosë atë nuk mjafton kjo bisedë e rastit. Detyrat e anëtarëve dhe qëllimi i veprimtarisë së tyre ishin të përcaktuara me status dhe program, por për ngritjen e anëtarëve të organizatës shfrytëzohej edhe literaturë e gjerë teorike, historike dhe revolucionare. Anëtarët zgjidheshin në bazë të njohjes paraprake, në bazë të bindjes së fituar për personin e caktuar, në bazë të provave, në bazë të qëndrimit, vendosmërisë dhe të sakrificës familjare...Anëtarët përgatiteshin që të jenë të aftë sa armikun ta tërheqim në fushën që donim ne e jo aty ku donte armiku. Anëtarët duhej të përgatiteshin për qëndresë, për konspiracion dhe për burg të rëndë. Ata përgatiteshin që luftën e ardhshme që ishte e pashmangshme mundësisht ta orientonim dhe ta bënim vetëm me Serbinë, sepse armiqësimi me popujt tjerë për ne ishte i papranueshëm. Demonstratat e vitit '81 Organizatën tonë, përkatësisht ne, Komitetin e Deçanit, na gjetën të lidhur edhe me komitetet në formim, si ai i Drenicës me Bajram Gashin në krye, i Gjakovës me Muhamet Rogovën, i Mitrovicës me Bislim Bajramin, i Llapit me Beqir Hajrizin, pastaj me ato në Gjilan, në Shkup dhe Stamboll si dhe disa celula të tjera të themeluara dhe në themelim e sipër. Anëtarësia e Komitetit ishte e gjerë. Sidomos në prag të demonstratave dhe gjatë demonstratave erdhi deri te një masivizim shumë i gjerë i anëtarësisë. Në kuadrin e Komitetit të Deçanit vepronte edhe grupi i të rinjve i quajtur “Shqiponjat”, i cili me celulat e veta të shumta zhvilloi një aktivitet të dendur dhe shumë të çmuar. Celulat e anëtarësisë vepronin në formën e treshit.

“Epoka e re”: *Anëtarët e parë të Komitetit u arrestuan. Ju kishit pasaportë. Shqipërinë e kishit vetëm dy hapa larg. Pse nuk u arratisët?*

Xhavit Hoxha: Demonstratat e detyruan Organizatën tonë të dalim hapur. Propagandonim, shkruanim parulla, shpërndanim pamflete, gazeta ilegale (“Lajmëtari i lirisë”, “Liria”, “Bashkimi”) dhe libra të ndaluar, organizonim bojkotimin e mbledhjeve diferencuese, sabotonim veprimtarinë e armikut, thërrisnim punëtorët që të fillojnë grevat, merrnim pjesë në demonstrata...Me një fjalë ishim kudo, fytafyt me armikun. Dalja jonë haptazi na kushtoi. U zbuluam dhe filloi burgosja jonë.

Vërtetë unë kisha pasaportë dhe kisha mundësi të arratisesha në Perëndim. Sa për kalimin e kufirit dhe ikjen në Shqipëri nuk e kisha asnjë problem sepse atë zonë e njihja si pëllëmbën e dorës. Lidhur me këtë çështje Organizata kishte qëndrim të prerë. Nga arrestimi mund të përjashtohej vetëm ndonjë rast i veçantë. Përndryshe, kishte ardhur koha kur burgjet jugosllave duhej të mbusheshin ding me atdhetarët shqiptarë që edhe në këtë mënyrë të dëshmohej para botës lufta jonë e drejtë për liri. Arrestimi masiv i anëtarëve të Organizatës tonë u bë në mëngjesin e hershëm të datës 10 maj 1981. Atë ditë u arrestova edhe unë. Forca të mëdha të milicisë, të rezervistëve të shumtë dhe të udbashëve të ardhur nga SPB-ja e Pejës, kishin rrethuar shtëpinë time dhe mbarë Junikun. Fillimisht, si mua ashtu edhe anëtarët tjerë, na dërguan në Burgun e Pejës, me përjashtim të Drita Kuqit, të cilën e mbyllën në pavionin e grave në Burgun e Mitrovicës. Ismajl Haradinaj dhe Hasan Ukëhaxhaj janë marrë në pyetje edhe nga inspektorët federativ të ardhur nga Beogradi. Hetuesit silleshin si bisha të çmendura. Por për dajak, mjerisht, ishin vendorët, shqipfolësit. Maltretimi bëhej sipas pozitës së të burgosurit. Dajak merrnin edhe ata që qëndronin të fortë, si Islam Mustafaj që pohonte: unë i di të gjitha, por nuk flas. Torturat më barbare janë zhvilluar sidomos mbi Ismajl Haradinajn. Gjykata e Pejës na dënoi me burg të rëndë me kohëzgjatje nga 3 deri në 14 vjet. Unë u dënova me katër vjet burg dhe dënimin e mbajta në burgjet namzeza në Leskovc dhe në Nish.

“Epoka e re”: *Në cilin burg u zhvilluan hetimet? Për çka akuzoheshit? Kush ju mori në pyetje?*

Xhavit Hoxha: Hetimet kundër Organizatës tonë u zhvilluan nga organet e UDB-së së Pejës. Akuza na ngarkonte për veprimtari armiqësore kundër popullit dhe shtetit jugosllav, sipas nenit 136 dhe 114, pra bashkim dhe kundërrevolucion. Me akuzën e parë u pajtuam të gjithë ngase me vetëdije kishim vepruar për rrënimin e shtetit jugosllav, ndërsa me akuzën e dytë nuk u pajtuam sepse ajo ishte shumë e pabazë dhe nuk përmbante kurrfarë elementesh me çka u dëshmua edhe gjatë gjykimit.

Hetuesit ishin shqiptarë, serbë dhe malazezë nga Peja, Prishtina dhe Beogradi. Se ishte bërë kiameti. Hej, kishim guxuar të ngrinim zërin kundër Jugosllavisë, kundër shtetit më të përkëdhelur të botës, sipas tyre shtetit më të fortë në Evropë! Po na dhimbeni se po i bini murit me kokë, i thanë Jashar Salihut gjatë hetimeve. Po shkoni dëm. Nuk e dini se Jugosllavia është superfuqi botërore. Jashari, siç ishte gjithmonë i qetë, ua kthen urtë: ne nuk ngutemi e as ndalemi, një tullë sivjet, një tullë vitin tjetër e kështu deri sa të jemi gjallë, deri sa të rrënojmë përfundimisht këtë shtet okupues. Konkretisht unë akuzohesha për zhvillimin, zgjerimin dhe formimin e komiteteve të reja, për detyra

speciale, për mbledhjen e informatave me qëllim publikimi, si dhe për iniciativën time lidhur me sigurimin e armatimit për luftën që shihej në horizont.

Demonstratat mendoheshin të ishin faza e parë e kryengritjes së armatosur

“Epoka e re”: *Veprimtaria e Organizatës suaj fillon një vit para shpërthimit të demonstratave të mars-prillit '81. Sa keni punuar për këtë ditë? Shpërthyen ato para kohe apo me kohë? Sa dhe si i përkrahët demonstratat?*

Xhavit Hoxha: Kemi punuar shumë që një ditë ta ngritim popullin në demonstrata masive, të cilat sipas Jusuf Gërvallës mendoheshin të ishin faza e parë e kryengritjes së armatosur të popullit shqiptar të robëruar në trojet e veta në Jugosllavinë tashmë të shkatërruar. Veprimtaria jonë ishte shumë e gjerë dhe karakterizohej nga shtimi i shkallës së aktivitetit. Në fillim puna jonë u dëshmua në mbarë Rrafshin e Dukagjinit dhe vetëm për pak muaj arritëm të zgjerohemi deri në Besianë, Gjilan dhe Shkup. Caku ynë kryesor ishte Universiteti i Kosovës. Veprimtaria jonë i mbulonte të gjitha trojet e robëruara shqiptare. Në prag të shpërthimit të demonstratave Jusuf Gërvalla përmes udhëzimeve që na i dërgonte si dhe përmes gazetës “Lajmëtari i lirisë” jepte lajmin kushtrim: “Po bëhet gati populli për hakmarrjen e vet të madhe. Do ta derdhim edhe pikën e fundit të gjakut tonë dhe do të ngadhënjëjmë mbi armiqtë dhe mbi tradhtarët e çdo ngjyre. Dita e lirisë po afrohet. Po vjen dita që armiku e tradhtari të japin llogari për krimet e poshtërsitë e bëra mbi popullin tonë...Vetëm të bashkuar e të vendosur, me besën e madhe shqiptare, do të arrijmë në fitoren tonë të sigurt...”. Demonstratat shpërthyen në kohën e duhur dhe ne na gjetën në krye të detyrës. Edhe pse nuk ishim organizatorë të drejtpërdrejtë të demonstratave ato na mobilizuan hala më shumë. Forca jonë duhej ta godiste pa mëshirë armikun. Për këtë ditë ishin flijuar me mijëra atdhetarë dhe me dhjetëra organizata atdhetare. Koha nuk priste më...

“Epoka e re”: *Klasa politike, atëherë dhe sot, pohon se u zu në befasi nga demonstratat e mars-prillit '81. Mendimi juaj?*


Xhavit Hoxha: Është e vërtetë se klasa politike e Kosovës u zu në befasi nga demonstratat e atij viti të madh si dhe nga rezistenca mbarëpopullore që pasoi gjatë viteve në vijim. Kishte kohë që klasa politike e Kosovës po jetonte në luks dhe po bënte jetë të shkëputur larg krahmatave, skamjes, padrejtësive të shumta dhe robërisë së padurueshme të popullit të vet. Duket se kjo klasë vasale e frymëzuar edhe nga padroni i tyre serbian kishte ardhur në përfundim se rinia shqiptare tashmë ishte tjetërsuar, ishte degjeneruar dhe ishte zhveshur nga çdo element kombëtar. Ata, pjesëtarët e kësaj klase, së bashku me padronin, mendonin se nuk ka më rini shqiptare, se rinia ka filluar

të bëjë një mënyrë tjetër jete, jetë qejfesh dhe shfrimesh banale sa nuk i bie më ndërmend Shqipëria, të cilës, sipas tyre, i mungonin edhe shporetet dhe televizorët. Kjo klasë ende u frikësohej vetëm veprimtarëve të vjetër të cilët i kishte mbyllur nëpër kazamatet mesjetare jugosllave dhe dukej se kishte harruar se në Kosovë po rritej një rini e uritur për bukë, për dituri dhe për liri, e cila vetëm po e priste momentin që të hidhej në beteja për t'i pushtuar të gjitha këto deri në një. Rinia jonë, asokohe, kishte ideale, mësonte, kërkonte rrënjët e historisë, ishte edukuar me përvojën e vuajtur të baballarëve të tyre, me përvojën e lavdishme të historisë së gjallë shqiptare, me mësimet kombëtare dhe revolucionare të Enver Hoxhës, ishte rritur me këngët e trimërisë të kënduara nga rapsodi i popullit Dervish Shaqa dhe me emisionet mbi heroizmin e popullit tonë ndër shekuj të Radio Kukësit dhe të Radio Tiranës.

“Epoka e re”: *Gjykatat e Kosovës të burgosurit politikë i dënuan në emër të popullit. Prokurorët, gjykatësit dhe hetuesit kanë bërë krime të mëdha në emër të ligjit të armikut. Ka kërkesa për rehabilitimin e ish të burgosurve politikë si dhe për dënimin moral të të gjithë atyre që morën pjesë në tragjedinë e Kosovës. Mendimi juaj?*

Xhavit Hoxha: Është e vërtetë se Serbia me ndihmën e argatëve të vet shqipfolës ka bërë kërdi mbi popullin e Kosovës. Ky mal me krime është i pafalshëm. Të paktën, këto krime patjetër duhet të mbeten të shënuara në analet e historisë. Brezat e ardhshëm duhet të mësojnë për këtë gjëmë. Lidhur me rehabilitimin tonë, me siguri, në kohëra më të mira, Kuvendi i Kosovës do të thotë fjalën e meritueshme. Sot kjo është e pamundur të bëhet. Ende jetojmë nën sundimin e të huajve. Sa u përket dënimeve, e kemi ditur edhe atëherë: na ka dënuar armiku dhe ne nuk kemi kërkuar mëshirë. Në bazë të punës sonë, shpërblim tjetër nuk kemi pritur nga armiku: na kanë burgosë, na kanë rrahë, na kanë vrarë, por krenohemi se kemi luftuar për fitoren e lirisë sonë, kundër shtetit armik shekullor. Dhe, këtë e kemi bërë me zemër dhe me të gjitha forcat që i kemi pasur. Kur na kanë quajtur nacionalistë dhe irredentistë nuk kanë hyrë në hak me ne sepse të tillë edhe kemi qenë. Njëherë e përgjithmonë kemi dashtë të çlirohemi dhe të bashkohemi me shtetin amë, me Shqipërinë e ëndrrave dhe të realitetit tonë. Fatkeqësisht, nuk kishim armë më të madhe se mendimin, letrën dhe grushtet tona të thata. Them për fat të keq, sepse punët do t'i kishim përfunduar qysh në muajin prill të vitit 1981 dhe sot do të kishim një shtet të zhvilluar, stabil dhe faktor i fortë paqeje në rajon dhe më gjer. Sot shqiptarët do të këndonin një këngë tjetër dhe nuk do të tërhiqeshim kështu zvarrë me zorë nëpër këmbë, si lypsarë të botës. Sikur ta kishim përfunduar revolucionin tonë në vitin 1981, nuk do të vinin në situatën e rëndë të poshtërimit gjatë viteve të 90 kur populli i manipuluar nga udbashët dhe nga bijtë e udbashëve na fyenin

me lloj-lloj emrash: si kuqaloshë, komunistë etj. Qëllimi i udbashëve ishte i qartë: ta thyenin tehun revolucionar dhe shpirtin luftarak të atdhetarëve të devotshëm, të njerëzve të sakrificës si dhe ta dobësonin përkrahjen e popullit ndaj nesh, me çka edhe patën sukses. Ky sukses i udbashëve u pa sidomos me rastin e organizimit të luftës çlirimtare të Kosovës, kur nga ta u sabotua çdo nismë e mbarë organizative. Personalisht mendoj se historia do t'i dënojë të gjithë individët që ishin në shërbim të Serbisë dhe që në mënyra të ndryshme morën pjesë në dënimin tonë dhe në tragjedinë e Kosovës gjatë viteve të tetëdhjeta. Ajo do t'i dënojë edhe individët dhe partitë të cilat jo vetëm nuk e përkrahën luftën e UÇK-së, por ishin kundër saj me të gjitha forcat. Nuk thotë kot populli: pushka atdhetare i mbyllë të gjitha shtigjet e ligësisë, pushka atdhetare pajton edhe gjaqe. Dhe, pushka për atdhe kërciti në vitet e fundit të shekullit të kaluar. Pushka për të cilën ishin flijuar shqiptarët një shekull të plotë. Dhe, për ironi, të gjithë ata që e shanë luftën e UÇK-së, në Kosovë dhe anë e mbanë botës, të gjithë ata që e sabotuan luftën deri në fund, u turrën pas mbarimit të saj, o burrani, dhe i zunë kolltukët udhëheqës, plaçkitën çka mund të plaçkitesh dhe sërish filluan sulmin kundër frontit që e bëri luftën. Kur jem te rehabilitimi, t'i them edhe dy fjalë. Vetëm në këtë qytet të vogël të Evropës ku jetoj unë jemi më tepër se dhjetë ish të burgosur politikë dhe të gjithë me fakultete të kryera. Kemi ndihmuar luftën dhe djemtë e UÇK-së me të gjitha mundësitë. Me djersën tonë mbajmë familjet tona dhe ende ndihmojmë nevojtarët në Kosovë. Por, kur po i shoh udbashët dhe bijtë e tyre në pushtet, prokurorët dhe gjykatësit e dikurshëm në vende të njëjta të punës, pseudointelektualët e dikurshëm pushtetarë dhe bijtë e tyre në vende udhëheqëse po më dhëmbë shpirti. Dikur si shërbëtorë besnikë të armikut ata i kanë shfrytëzuar të gjitha të mirat e pushtetit komunist jugosllav. Sot i shfrytëzojnë të gjitha të mirat që ua dha demokracia ndërkombëtare: vila, hotele, tenderë, rroga të majme, rryshfete, hajni etj. etj. Më bëhet se kjo botë qenka e krijuar për të mirën e gjakësorëve dhe për vuajtjen e të mirëve. Turp. Megjithatë, turpi nuk po çelte varrë askënd. Ne që jemi dergj burgjeve dhe hetuesive, të rrahur dhe të fyer në mënyrën më çnjerëzore, ne që nuk na lanë ta vuajmë dënimin me burg as në Kosovë, ne që me dhunë u detyruam ta braktisim atdheun dhe u degdisëm meridianeve në internim të përjetshëm nuk i ramë në qafë Kosovës për asgjë personale. Ne, në parim, iu përmbajtëm urtisë së Xhon Kenedit. Dhe kemi mbetur të njëjtit idealistë me gatishmërinë që deri në vdekje të punojmë dhe të flijohemi për lirinë, për gjuhën, për flamurin, dhe për bashkimin e kombit në një shtet. Kosovën as e kemi gënjyer, as e kemi vjedhur ndonjëherë. Prandaj as kërkojmë shpërblime prej saj. Kemi vetëm një lutje: Zot dhe Popull, na pranoni ashtu sikur na keni lindur, ashtu sikur na keni mësuar, ashtu sikur na keni edukuar.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Shqipëria barazon ndaj Ishujve Faroe, përfundon e para në grup

“Epoka e re”

TIRANË, 20 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll ka luajtur baras në “Air Albania” ndaj Ishujve Faroe me rezultat 0-0, në ndeshjen e fundit kualifikuese për Kampionatin Evropian. “Kishim dëshirë të bëjmë lojë të mirë për tifozët dhe të shënonim gola. Por, objektivi i parë ishte të kualifikohemi e i dyti të fitojmë grupin. Këtë e arritëm dhe kjo është e rëndësishme. Nuk e kemi nënvlerësuar kundërshtarin, ai ishte shumë fizik. Kundërshtari ishte gati dhe nuk ishte i lodhur si ne. Nuk bën të nënvlerësohet asnjë ekip pasi të gjitha kanë kualitet”, ka thënë Berat



Gjimshiti, kapiten i Shqipërisë. Shqipëria lëshoi tri raste të mira shënimi në pjesën e parë të ndeshjes. Në fillim të pjesës së dytë mysafirët rrezikuan nëpërmjet Bjartalid, i cili për pak

sa nuk surprizoi portierin Strakosha. Daku dhe Asani patën raste shënimi, por që nuk u shfrytëzuan dhe ndeshja përfundoi me rezultat 0-0. Me përfundimin e kësaj sfide është

mësuar dhe renditja përfundimtare e grupit E, ku në vendin e parë renditen kuqezinjtë me 15 pikë, teksa menjëherë pas tyre, me pikë të barabarta vjen Republika Çeke. Në vendin e 3-të është pozicionuar Polonia me 11 pikë, ndërsa në vendin e 4-të e të 5-të, Moldavia e Ishujt Faroe, me 10 e 3 pikë.

20 kombëtare evropiane kanë siguruar edhe zyrtarisht deri më tani kualifikimin në Kampionatin Evropian 2024 që mbahet në Gjermani. Të hënën edhe tri kombëtare tjera siguruan plasmanin në “Euro 2024”. Italia, Çekia dhe Sllovenia janë kombëtares që siguruan Evropianin. Gjermania ka qenë

skuadra e parë si vendi pritës, e me radhë sipas kohës kur janë kualifikuar kanë siguruar biletën edhe Belgjika, Franca, Portugalia, Skocia, Spanja, Turqia, Austria, Anglia, Hungaria, Sllovakia, Shqipëria, Danimarka, Holanda, Rumania, Zvicra, Serbia, Italia, Çekia dhe Sllovenia janë të gjitha kombëtares e kualifikuara zyrtarisht. Ndërkohë që dilema e vetme për sa i përket kualifikueseve mbetet ai në Grupin D, ku Kroacia dhe Uells janë në garë për një vend në Evropian. Tashmë ka mbetur vetëm verdikti i Grupit D dhe “play-off”-i i Ligës së Kombeve që do të caktojë tri emrat që plotësojnë kuadrin e 24 ekipeve pjesëmarrëse në “Euro 2024”.

Kosova përballet me Bjellorusinë, Gliha e Aliti: Të vazhdojmë serinë pozitive

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Përzgjedhësi Primozh Gliha dhe kapiteni Fidan Aliti janë paraqitur në konferencën për media në prag të ndeshjes kundër Bjellorosisë, teksa kanë theksuar se ekipi është i përqendruar dhe i motivuar maksimalisht për të vazhduar serinë pozitive dhe për ta përmbyllur këtë cikël kualifikues për “Euro 2024” me fitore. “Koncentrimi im është tek Bjellorusia, por nëse duhet të flasim për ndryshime atëherë absolutisht nuk ka asgjë që do të ndryshojë. Për mua gjërat janë të qarta, duhet t'i zbatojmë rregullat

që janë. Për mua është e rëndësishme të luajë gjithmonë ai që është më i miri. Nuk kanë rëndësi emrat, por cilësitë e futbollistëve. Këtë e kemi dëshmuar edhe në ndeshjet që i kemi luajtur dhe kështu do të duhej të vazhdonim. Secila ndeshje e ekipit kombëtar është e rëndësishme, sepse ekipi kombëtar është ekip kombëtar, nuk është klub. Këtu nuk ka kalkulime. Askush nuk mund të kalkulojë me ekipin kombëtar”, u shpreh Gliha. Ai e ka vlerësuar Bjellorusinë si kundërshtar shumë të fortë, por po ashtu ka



thënë se beson tek ekipi i tij dhe do të japin më të mirën për të arritur

një tjetër rezultat të mirë. Ndërkaq, kapiteni Fidan Aliti ka thënë se tani

nuk është koha për analiza se çfarë ka shkuar mirë e çfarë keq, porse janë të përqendruar për të bërë një tjetër paraqitje të mirë para tifozëve dardanë. “Edhe pse nuk kemi gjasa për kualifikim, për neve kjo është një ndeshje e rëndësishme. Secili prej nesh duhet të fokusohet në këtë ndeshje dhe ta mbajmë pozitën aktuale në tabelë dhe të mos lejojmë Bjellorusinë të na kalojë”, ka thënë Aliti. Ai ka vlerësuar edhe futbollistët e rinj, të cilët janë paraqitur në ndeshjet e fundit dhe ka shprehur shpresën për lojë të mirë edhe kundër Bjellorosisë.

‘Dardanët’: Ta mbushim stadiumin ‘Fadil Vokrri’ ndaj Bjellorosisë



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do ta mbyllë kampanjën kualifikuese për në Kampionatin Evropian “Euro 2024” me sfidën ndaj Bjellorosisë e cila zhvillohet të martën në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Gjasat për kualifikim tashmë janë shuar pas barazimit 1-1 me Zvicrën, por grupi i tifozëve “Dardanët” ka bërë thirrje të mbushen tribunat në stadiumin “Fadil Vokrri” për ta

mbështetur skuadrën përfaqësuese. “Të martën luajmë ndeshjen e fundit kualifikuese kundër Bjellorosisë. Ani pse shpresat për kualifikim në Evropian janë shuar, pas paraqitjes vetëmohuese të treguar në Bazël, djemtë meritojnë përkrahjen më të madhe të mundshme në mënyrë që ta mbarojmë me një fitore këtë cikël. Ftojme anëtarët tanë të jenë pjesëmarrës në tribunën e veriut në formë sa më masive. Si

githmonë, ju ftojme që të koordinoheni me përgjegjësit nëpër qendrat e ndryshme të vendit, të cilët do të ju orientojnë për organizimin, nisjen drejt Prishtinës dhe detajet tjera. Njëherësh kjo do të jetë edhe ndeshja e fundit që do ta luajë Kosova për këtë vit kalendarik, kështu që mungesa në stadium nuk gjen arsyetim për askënd, jo vetëm anëtarët e tifogrupit tonë”, thuhet në njoftimin e “Dardanëve”.

Në fundjavë zhvillohet Kampionati i Kosovës në Boks

Prishtinë, 20 nëntor - Federata e Boksit e Kosovës (FboxK) do ta organizojë Kampionatin Individual në Boks për Seniorë dhe të Rinj më 25 dhe 26 nëntor në

Palestrën e Sporteve të Shkollës Filllore “Mihal Grameno” në Fushë-Kosovë. Siç ka bërë me dije kjo federatë, të drejtë pjesëmarrje kanë të gjitha klubet e

regjistruara në FBOXK për vitin 2023. Të drejtë pjesëmarrje kanë boksierët që kanë minimum pesë meçe të zhvilluara. Të shtunën nga ora 11:00-12:00 do të bëhet

peshimi i boksierëve, kurse nga ora 16:00 do të zhvillohen gjysmëfinalet. Të dielën peshimi i boksierëve bëhet nga ora 08:00-09:00, kurse finalët fillojnë nga ora 12:00.




De Gea refuzon superofertën e Al-Nassrit

MADRID, 20 NËNTOR - David De Gea qëndron pa skuadër prej muajit korrik, kur i dha fund aventurës 12-vjeçare me Manchester Unitedin. Portieri spanjoll ka marrë disa oferta, por ende nuk ka zgjedhur skuadrën e radhës. Teksa po pret janarin për

të firmosur dhe për t'u rikthyer mes portave, së fundmi ka marrë një ofertë të majme nga Arabia Saudite, por është detyruar ta refuzojë për shkak të bashkëshortes së tij. Al-Nassru, klubi ku bën pjesë edhe Cristiano Ronaldo, i ka ofruar 33-vjeçarit

rreth 500 mijë paund në javë, por Edurne Garcia Almagro, gruaja e “gardianit” iberik, ka vendosur veton, pasi nuk dëshiron të jetojë në Arabinë Saudite. Dhe Davidi e ka dëgjuar duke iu përgjigjur negativisht propozimit saudit. E ardhmja e portierit pritet të jetë

në MLS-në amerikane. Nuk përjashtohet edhe opsioni i rikthimit në “Old Trafford”. Andre Onana do të mungojë në janar për shkak të Kupës së Kombeve të Afrikës. Dhe “Djajtë e Kuq” po e mendojnë seriozisht rikthimin e De Geas.



Leclerc: Kjo ishte gara ime më e mirë me Ferrarin këtë sezon

LAS VEGAS, 20 NËNTOR - Një tjetër garë e nisur nga “pole position” nga ana e pilotit monogask Charles Leclerc nuk i dha atij fitoren ashtu sikurse ndodhi në Las Vegas. Gjithsesi, vendi i dytë që korri në këtë garë, pas një parakalimi spektakolar ndaj Sergio Perez dy kthesa nga fundi, ishte si një fitore për pilotin e Ferrarit. “Nga njëra anë është adrenalina e xhiros së fundit dhe të parakalimit në kthesat e fundit. Nga ana tjetër është zhgënjimi që nuk arritëm dot te fitorja, pasi në këtë garë mund t’ia kishim dalë mbanë. Ishim më të shpejtët në pistë por, për fat të keq, na penalizoi makina e sigurisë, që hyri në momentin e gabuar”, ka thënë Leclerc. “Fakti që gomat e mia u përdorën 5 xhiro më shumë nuk ndikoi. Dhashë gjithçka në pistë, por mund të them që fati nuk na ndihmoi. Nuk



bëmë gabime në këtë garë, ndaj buzëqeshim sadopak edhe me këtë vend të dytë. Fakti që jemi vetëm 4 pikë pas Mercedesit na jep besim për garën e radhës, ku vendoset gjithçka”, ka deklaruar Leclerc. “Mendoj se kjo ishte

makina më e mirë Ferrari që kam pilotuar këtë sezon për sa i përket ritmit të garës. Shpresoj që kështu të vazhdojmë edhe në garën e fundit, pasi kemi nevojë për një tjetër paraqitje të mirë e ta kapim vendin e dytë”, u shpreh Leclerc.

LeBron ua jep fitoren lakersve, Bostoni e Philadelphia shkëputen në Lindje

LOS ANGELOS, 20 NËNTOR - Pavarësisht moshës, LeBron Jamesi nuk ndalet, duke realizuar 37 pikë në fitoren 105-104 të lakersve ndaj Houstonit në NBA. Ky është sukse si i dytë radhazi për kalifornianët, që ngjitin shkallët në renditje. Mirë u paraqit edhe Davisi me 27 pikë, një dyshe që bëri dallimin në parket. Fiton edhe Philadelphia, që mundi Brooklynin (121-99) jashtë fushës, duke konsoliduar vendin e dytë në Lindje. Joel Embiid realizoi 32 pikë e 12 rebounde, mbështetur nga Maxey me 25 pikë e Meltoni me 21 pikë. Humbet sërish ekipi i Dallasit, që u mund nga



Clevelandi (121-109), sfidë ku u dallua Sabonisi me 32 pikë e 13 rebounde. Në krye të renditjes në Lindje qëndron Bostoni, që fitoi në fund ndaj Memphisit (102-100) jashtë fushës. Porzingis me 26

pikë ishte lider në fushë për Celticsin. Pas kohës shtesë fitoi Phoenixi, që mundi me rezultat 140-137 Utah Jazzin, sfidë ku Kevin Duranti realizoi 39 pikë e 10 asistime për Suns-in.

SUPERLIGA - Java 9		
Brooklyn - Philadelphia	99-121	
Toronto - Detroit	142-113	
Indiana - Orlando	116-128	
Dallas - Sacramento	113-129	
Memphis - Boston	100-102	
Utah Jazz - Phoenix	137-140	
Portland - Oklahoma	91-134	
Lakers - Houston	105-104	

SHKURT

Përfundon sezoni për Gavin

Ylli i Barcelonës dhe Kombëtares së Spanjës, Gavi, në sfidën kundër Gjeorgjisë pësoi një lëndim të rëndë dhe doli nga fusha me dhimbje e lot në sy. Pas lëndimit, ai është rikthyer në Barcelonë për t'i kryer të gjitha ekzaminimet përkatëse, por përflitet se mungesa e tij do të jetë e gjatë. Ashtu siç bëjnë me dije mediet spanjolle, Gavi ka lënduar ligamentet e gjurit dhe kështu pritet që ai ta mbyllë sezonin me Barcelonën dhe ta humbasë Kampionatin Evropian me Spanjën.

Unitedi synon transferimin e Griezmannit

E ardhmja e Antoine Griezmannit mund të jetë në Premierë Ligë, pasi klubi i Manchester Unitedit po e dëshiron francezin në radhët e veta. Mediet në ishull raportojnë se “Djajtë e Kuq” tashmë kanë nisur negociatat për ta kuptuar disponueshmërinë e sulmuesit francez për një transferim në “Old Trafford”. Unitedi propozon një pagë prej 21 milionë eurosh në sezon për Griezmannin, pothuajse trefishi i asaj që fiton aktualisht tek Atletico Madridi. Grizmann ka bërë karrierë në klube si Real Sociedad, Barcelona dhe Atletico Madridi.

Ancelotti në bisedime me Realin për rinovimin e kontratës

Carlo Ancelotti mund të jetë trajner i Real Madridit të paktën edhe në edicionin e ardhshëm. Në Spanjë raportohet se tekniku italian është në bisedime me klubin spanjoll për ta rinovuar kontratën. Ancelotti është pjesë e Realit nga viti 2021 dhe sukseset kanë qenë të mëdha në këtë periudhë. E kjo ka bërë që drejtuesit e “Los Blancos” të interesohen për të zgjatur edhe për dy vjet kontratën me teknikun italian. Mbetet të shihet nëse do të arrihet një marrëveshje mes klubit dhe lojtarit, teksa harmonia mes tyre shihet të jetë mjaft e mirë.

Tottenhami planifikon transferimin e Raphinhas në janar

E ardhmja e mesfushorit brazilian Raphinha mund të jetë sërish Premierë Liga ku ai luante deri në vitin 2022. I ardhur te Barcelona, lojtari 26-vjeçar nuk ka gjetur shkëlqimin e dikurshëm, kur aktivizohej me Leeds Unitedin në Angli. Këtë herë për mesfushorin është interesuar ekipi i Tottenhamit, që do të synojë ta sjellë në Londër Raphinha që në merkaton e janarit. Dëmtimi i Madissonit duket se ka detyruar skuadrën e Spursit të hedhë sytë në merkato dhe Raphinha konsiderohet si element i duhur. Skuadra londineze ka nisur bisedimet si me lojtarin ashtu dhe klubin katalanas për ta siguruar mesfushorin. Për brazilianin, skuadra e Barcelonës kërkon rreth 70 milionë euro, ndërkohë që kontrata aktuale skadon në vitin 2027. Raphinha nuk e ka të sigurt vendin e titullarit te Barcelona ndaj largimi i tij duket se është mundësia më e mirë për t'u aktivizuar më shumë. Tottenhami është gati të ofrojë në këtë marrëveshje edhe Cristian Romeron, ndaj Barcelona po studion të gjitha opsionet e mundshme.

Sane nuk mendon për rinovimin e kontratës me Bayernin

Skuadra e Bayern Munchenit nuk është më në planet e mesfushorit Leroy Sane, që synon t'i lërë kampionët e Gjermanisë. Anëtori i ekipit bavarez ka refuzuar disa herë

takimet me klubin për rinovimin e kontratës, e cila skadon në verën e vitit 2025. Sipas së përditshmes spanjolle “Sport”, lojtari është duke menduar për t'u larguar, mundësisht në

drejtim të Spanjës, ndaj dhe refuzon të ulet në bisedime me Bayernin. Kjo ka sjell irritimin e drejtuesve të kampionëve të Gjermanisë, që duan ta mbajnë 27-vjeçarin përtej kontratës

aktuale. “Për momentin nuk kam menduar për rinovimin. Klubi dëshiron të hapë një dialog, por tani dua të përqendrohem te sezoni aktual”. Mësohet se Real Madridi dhe Barcelona janë vënë

në gjurmë të lojtarit gjerman, që kushton rreth 70 milionë euro. Ende asnjë klub nuk ka bërë ndonjë ofertë zyrtare për Leroy Sanen, por duket se lamtumira është e paevitueshme.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “King Group” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Burim Bajrami, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811874446 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "King Group" D.O.O. Gnjilane, sa vlasnikom Burim Bajrami, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811874446 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “King Group” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Burim Bajrami, has come to the decision to quit its business: 811874446 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Emri i biznesit B5 Inframain
SH.P.K. si dhe me emër tregtar
B5 Infrastructur&Maintance me
Numër Unik Identifikues:
811574583, ka marr vendim për
zvogëlim të kapitalit nga
2000.000 në 20.000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qerim Nairaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës sh.m.t “Nexhmedin Nixha”.
-
- Agnesa Nimani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”.
-
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
-
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
-
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
-
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
-
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLESË RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.O.O.
Rruga e Liqenit p.u. – 40000 Mitrovicë
Data: 21.11.23 Nr.: 1661

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica” Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi)

I. Emërtimi i vendit të punës: Bagerist (Ekskavatorist)

Përgaditja profesionale: Shkolla Filllore ose e Mesme

Përvoja e punës: Së paku 1 vit.

Numri i kryerësve: 1.

Kushtet të veçanta:

- Të jetë punëtor i kualifikuar Bagerist (Ekskavatorist).

Paga Bazë: 494.37 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU “Mitrovica”.

Orari: I plotë.

Vendi i punës: KRU “Mitrovica” Sh.A Njësia Vushtrri

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat,
- Kryen projektimin e rrjetit të objektit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Bënë marrjen e urdhërave për përdorimin e makinës me të cilën është i ngarkuar personalisht përdor sipas urdhërësës,
- Pastron dhe bënë lyerjen dhe mirëmbajtjen e makinës me të cilën është i ngarkuar,
- Punonjësi është i ngarkuar dhe është përgjegjës për mjete të cilat i përkasin makinës dhe është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre,
- Punëtori i cili punon në këtë vend të punës është përgjegjës për kryerjen e punëve me urdhërin e përgjegjësit të tij,
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës që merr nga Udhëheqësi/sja,
- Për punën që kryen i përgjigjet Shefit të Mekanizmit

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Shkolles së Mesme apo Deftesa e Shkolles Filllore (orgjinali nga kopja e noterizuar, kurse jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës (trusti),
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënvra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU “Mitrovica” Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/> si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data 21.11.2023 deri me datën 05.12.2023.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranua të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisni dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtë nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.







MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLESË RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.O.O.
Rruga e Liqenit p.u. – 40000 Mitrovicë
Data: 21.11.23 Nr.: 1661

U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje postupaka u vezi sa oglasom za radna mesta u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

OGLAS ZA RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

I. Naziv radnog mesta: Bagerista

Profesionalna kvalifikacija: Osnovna ili Srednja Škola

Radno iskustvo: Najmanje (1) godina

Broj pozicija: (1)

Posebni uslovi:

- mora biti kvalifikovan bagerista

Osnovna plata: 494.37 €, na osnovu Uredbe o raspodeli prihoda u RVP Mitrovica

Radno vreme: Puno

Radno mesto: RVP - Jedinica u Srbici

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- može da obavlja zadatke sa punim radnom vremenom i bez ograničenja,
- izvodi projektovanje mreže objekta vodovoda i kanalizacije,
- prima naloge za korišćenje automobila kojim je zadužen i lično ih koristi po nalogu,
- čisti i radi farbanje i održavanje automobila za koje je zadužen,
- zaposleni je zadužen i odgovoran je za alate koji pripadaju automobilu i odgovoran je za njihovo skladištenje i održavanje,
- zaposleni koji radi na ovom radnom mestu odgovoran je za obavljanje poslova po nalogu svog pretpostavljenog,
- obavlja i druge poslove po nalogu koji dobije od Vode,
- za posao koji obavlja odgovoran je Vode Mehanizma

Potrebna dokumentacija:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Diploma srednje škole ili Potvrda osnovne škole (overena kopija, dok diploma sa ustanove u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu (trust),
- Kopija lične karte.

Način prijave:

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od 21.11.2023 do 05.12.2023.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.

NAPOMENA: Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.





